



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

Nr. 343 Prot.

Tiranë, më 25/02/2025

URDHËR

Nr. 2 datë 25/02/2025


PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT *AD HOC* PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE
FITUES PËR PUNONJËS MËSIMOR NGA KATEGORIA LEKTOR/ASISTENT
LEKTOR, NË PROGRAMIN E STUDIMIT PIKTURË KAVALETI, TË NJËSISË BAZË
PIKTURË, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA, TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE**

Mbështetur në nenin 64, pika 1 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin nenin 40, pika 1, germa “g”, në nenin 40, pika 3 si dhe në nenin 56, pikat 5 dhe 6 të Statutit të Universitetit të Arteve, në vendimin gjyqësor me nr. 1798, datë 22.05.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në shkresën nr. 207 prot., datë 28.01.2025 të Rektorit të UART, në Buletinin nr. 6, datë 03.02.2025 të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe në shkresën nr. 5 prot., datë 24.02.2025 nëpërmjet së cilës përcillen propozimet e Njesisë Bazë Pikturë për 2 (dy) nga anëtarët që do të përbëjnë komisionin *ad hoc*,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për punonjës mësimor nga kategoria Lektor/Asistent lektor, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, të Njesisë Bazë Pikturë, në Fakultetin e Arteve të Bukura, të Universitetit të Arteve, me këtë anëtarësi:
 - a. **Dr. Ermir Hoxha – Kryetar, (Përgjegjës Njësia Bazë)** (përzgjedhur nga Njësia Bazë);
 - b. **Prof. Artan Peqini – Anëtar, (Drejtues Programi)** (përzgjedhur nga Njësia Bazë);
 - c. **Dr. Rozela Dhimgjini – Anëtar,** (përzgjedhur nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore);
 - d. **Prof. Asoc. Edmond Gjipopulli – Anëtar,** (përzgjedhur nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore).



2. Si drejtues i njësisë kryesore kërkoj caktimin e anëtarit të pestë nga Rektori i Universitetit të Arteve në këtë komision.
3. Komisioni *ad hoc*, më datë **28.02.2025** të shqyrtojë dosjet e kandidatëve si fazë e parë e vlerësimit të tyre, dhe më tej, për ata kandidatë të kualifikuar nga faza e parë, të zhvillojë fazën e dytë, atë të intervistës dhe mësimdhënies. Faza e intervistës dhe mësimdhënies do të zhvillohet më datë **03.03.2025**, ora **10.00**.
4. Komisioni *ad hoc*, në përfundim të procesit të vlerësimit të kandidatëve, t'i paraqesë Drejtuesit të Njësisë Kryesore të Fakultetit të Arteve të Bukura rezultatet përfundimtare, për t'u përcjellë në vijim pranë Rektorit të Universitetit.
5. Ky urdhër t'i bëhet me dije anëtarëve të Komisionit *ad hoc*, sipas pikës 1 të këtij urdhri, si dhe t'i njoftohet Rektorit të Universitetit të Arteve dhe Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ-P/A.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof. Sadik Spahija

